



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR PËR TË DREJTËN E AUTORIT

Nr. 20 Prot.

Tiranë, më 19 / 11 / 2018

VENDIM

Nr. 8, datë 19 . 11 . 2018

“PËR

**TRANSFERIMIN E FUNKSIONIT TË MBLEDHJES SË TARIFAVE PËR TË
GJITHA KATEGORITË E MBAJTËSVE TË TË DREJTAVE TË AUTORIT DHE
TË DREJTAVE TË TJERA TË LIDHURA ME TO NË ADMINISTRIMIN
KOLEKTIV DHE DREJTIMIN E SPORTEELIT UNIK TË ADMINISTRIMIT TË
SË DREJTËS TË AUTORIT - SUADA”**

Në zbatim të nenit 138 të ligjit nr. 35, datë 31.03.2016 “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”; vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 35, datë 18.01.2017 “Për mënyrën e funksionimit, të organizimit dhe të shpërblimit të Këshillit Kombëtar për të Drejtën e Autorit”; vendimit të Këshillit Kombëtar për të Drejtën e Autorit nr.2, datë 20.04.2017 “Për miratimin e rregullores të organizimit dhe funksionimit të Këshillit Kombëtar për të Drejtën e Autorit (KKDA)”, vendimit të Këshillit Kombëtar për të Drejtën e Autorit nr.5, datë 11.10.2018 “Për hapjen e procedurave për konkurim nga agjencitë e administrimit kolektiv për zgjedhjen e Agjencisë unike për kryerjen e funksionit të mbledhjes së shpërblimeve (Sporteli unik)”,

Këshilli Kombëtar për të Drejtën e Autorit në mbledhjen e vet të radhës datë 19.11.2018, me rend dite miratimin e agjencisë në favor të së cilës kalon funksioni kolektiv i mbledhjes së tarifave të shpërblimit në kuptim të nenit 138 të ligjit 35/2016 si dhe drejtimin prej saj të sportelit unik SUADA, mori në shqyrtim dosjet me propozimet e mëposhtme:

- a) Strategjia e AKDIE për Sportelin Unik për të Drejtat e Autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me të me nr. Protokolli hyrës nr. 16 datë 29.10.2018;
- b) Platforma e përbashkët e Agjencisë ALBAUTOR dhe GRAMM-A për drejtimin e Sportelit Unik të Administrimit të së drejtës së autorit SUADA nga ana e Agjencisë Albautor dhe Drejtuesit ekzekutiv të saj, me nr. Protokolli hyrës nr.17 datë 30.10.2018;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR PËR TË DREJTËN E AUTORIT**

Propozimet e paraqitura të agjencisë AKDIE dhe ALBAUTOR-GRAMM-A parashtrojnë informacion lidhur me përmbushjen e kushteve të nenit 138 të ligjit 35/2018 dhe kanë paraqitur strategjinë se si duhet të drejtohet sporteli unik SUADA.

Gjithashtu, përvec dokumenteve shkresorë të depozituara, palët prezantuan me përfaqësuesit e tyre pranë KKDA-së në mbledhjen e datës 19.11.2018, platformat përkatëse për drejtimin e sportelit unik SUADA.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe prezantimeve të projekt-propozimeve, KKDA arsyeton se platforma e paraqitur nga Albautor-GRAMM-A përmbush kriteret dhe është më e përshtatshme dhe efektive në kryerjen e funksionit të mbledhjes së tarifave të shpërblimit dhe formës së bashkëpunimit me organet shtetërore. Gjithashtu, KKDA vlerëson faktin që ky propozim ka ardhur si një frymë bashkëpunimi nga dy agjenci të administrimit kolektiv, i cili është edhe një nga parimet në përmbushjen e detyrave të sportelit unik.

KKDA në vlerësimin e platformës së agjencisë AKDIE, shpreh dyshime lidhur me suksesin e strategjisë së propozuar në formën e bashkëpunimit me organet shtetërore. Gjithashtu KKDA, në vijim edhe të eksperiencës së kaluar për drejtimin e SUADA-s, vlerëson se drejtimi i ri i SUADAs duhet të jetë me një afat të përcaktuar për të vlerësuar performancën e saj.

Sa më sipër, duke administruar të gjithë informacionin e nevojshëm dhe pas shqyrtimit të platformave të paraqitura, Këshilli Kombëtar për të Drejtën e e Autorit në zbatim të nenit 138 të ligjit 35/2016 *‘Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të’*:

VENDOSI:

1. Transferimin e funksionit të mbledhjes së tarifave për të gjitha kategoritë e mbajtësve të të drejtave të autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me to në administrimin kolektiv, në bazë të nenit 138, të ligjit 35/2016, agjencisë së administrimit kolektiv “Albautor” me Drejtor Ekzekutiv Z. Erlir Puto deri në datë 31 Dhjetor 2019, sipas propozimit të përbashkët të AAK-ve ALBAUTOR dhe GRAMM-A.
2. Pas kalimit të afatit të përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, zbatohet neni 138 i ligjit 35/2016 *‘Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të’*



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR PËR TË DREJTËN E AUTORIT**

3. Mënyra dhe përqindjet e ndarjes së tarifave dhe shpërblimit të mbledhur ndaj AAK-ve të kryhet në zbatim të pikës 3 të nenit 138 ligjit 35/2016 *‘Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të’*.
4. Për sa nuk bien ndesh me këtë vendim, pikat e miratuara në Vendimin Nr.4 datë 10.10.2017 të Këshillit Kombëtar për të Drejtën e Autorit *‘Për transferimin e funksionit kolektiv të mbledhjes së tarifave të shpërblimit për të gjitha kategoritë e mbajtësve të të drejtave të autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me to drejt njëres prej agjencive të administrimit kolektiv dhe për drejtimin e sportelit unik për administrimin e të drejtës së autorit-SUADA’* zbatohen nga SUADA.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Ministrisë së Kulturës si dhe në Fletoren Zyrtare.
6. Kundër vendimit të Këshillit Kombëtar për të Drejtën e Autorit, palët kanë të drejtë të ankohen në gjykatën kompetente brenda afateve të parashikuara në Kodin e Procedurës Administrative. Afati i ankimit, llogaritet nga data e njoftimit të këtij vendimi.
7. Ngarkohet sekretariati teknik i Këshillit Kombëtar për të Drejtën e Autorit për njoftimin e këtij vendimi.

KRYETARI I KKDA

INES MUÇOSTEPA

SEKRETAR I KKDA

SOFJAN JAUPAJ

